



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura III
Sesioni pranveror

Komisioni për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport dhe Telekomunikacion
Mbledhja nr. 23/2009
Më 21. 07. 2009, në orën 11:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-225

Procesverbal

Në mbledhje morën pjesë: Myzejene Selmani - kryetare e Komisionit, Ethem Çeku, Sala Berisha – Shala, Fatmir Rexhepi, Kaqusha Jashari, Safete Hadërgjonaj, Berim Ramosaj dhe Zef Morina.

Munguan: Slobodan Petroviq dhe Múfera Şinik.

Pjesëmarrës të tjerë: William Klawonn dhe Haxhi Gashi – USAID, Lumnije Murati – ZPK, dhe Driton Selmanaj -KDI.

Nga Zyra Mbështetëse: Hasan Tahiri, Advije Morina, Armend Ademaj dhe Besim Haliti.

Mbledhjen e drejtoi: Myzejene Selmani - kryetare e Komisionit.

Rendi i ditës

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së datës 14.07.2009;
3. Shqyrtimi i Projektligjit për masat antidamping;
4. Shqyrtimi i Vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 02/70 të datës 25.06.2009, lidhur me propozimin e anëtarëve të Bordit të ART-së;
5. Shqyrtimi i Udhëzimit administrativ Nr. 07/2009;
6. Shqyrtimi në parim i Projektligjit për përcaktimin e të drejtave dhe të mbrojtjes së topografisë së qarqeve të integruara;
7. Të ndryshme;

I. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pasi u hoq pika e pestë (5) e rendit të ditës.

II. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së datës 14. 07. 2009

Procesverbali i mbledhjes së datës 14. 07. 2009 u miratua pa vërejtje.

III. Shqyrtimi i Projektligjit për masat antidamping

Kryetarja – ia dha fjalën raportuesit të Grupit të punës- Berim Ramosaj, që të raportonte për Projektligjin për masat antidamping.

se Grupi i Punës e ka shqyrtuar Projektligjin për masat antidamping dhe ka përgatitur Raportin me amendamente, që ia paraqet Komisionit për miratim. Njëkohësisht për mbështetje dhe kontribut e falënderon edhe USAID-in.

Pas debatit të gjerë Komisioni, nxori këtë:

Përfundim

I. Miratohet raporti për Projektligjin për masat antidamping

IV. Shqyrtimi i vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 02/70 të datës 25.06.2009, lidhur me propozimin e anëtarëve të Bordit të ART-së

Zef Morina – tha se kërkesa e Qeverisë është e panevojshme t'i dërgohet Komisionit për shqyrtim, sepse nuk është obligim ligjor, por e drejtë ekskluzive e ministrit që t'i caktojë anëtarët e Bordit të ART-së. Mirëpo- shtoi, se nuk ka gjë të keqe që edhe Komisioni ta miratojë këtë kërkesë dhe e përkrahu.

Fatmir Rexhepi – theksoi se e përkrah plotësisht listën e propozuar dhe shtoi se është një prej listave më të mira të paraqitura deri më tash nga Qeveria, sepse ka një përbërje me ekspertë të mirë.

Safete Hadergjonaj – theksoi se e mira e kësaj është që tanimë kemi një lëvizje përpara që të plotësohet Bordi i ART-së, duke marrë parasysh situatën në të cilën ka qënë. Ajo e përkrahu në parim listën e propozuar, mirëpo shtoi se ka mangësi në dokumentacionin e ofruar, sepse ka vetëm nga një CV dhe asnjë dokument tjetër që do t'i tregonte kualifikimin dhe përvojën e tyre. Në fund tha se e përkrah në parim, në mënyrë që të procedohet tutje në seancë.

Po ashtu deputetët **Kaqusha Jashari** dhe **Berim Ramosaj** e përkrahën propozim-vendimin e Qeverisë për anëtarët e Bordit të ART-së.

Pas debatit Komisioni, nxori këtë

Përfundim

- I. Miratohet Propozimvendimi i Qeverisë së Republikës së Kosovës nr.02/70 i datës 25.06.2009, lidhur me propozimin e anëtarëve të bordit të ART-së.
- II. Komisioni Rekomandon të plotësohet me dokumentacion shtesë për kualifikimet dhe për përvojën e të propozuarve.

VI. Shqyrtimi në parim i Projektligjit për përcaktimin e të drejtave dhe të mbrojtjes së topografisë së qarqeve të integruara.

Kryetarja – kërkoi të përkrahet në parim Projektligji për përcaktimin e të drejtave dhe të mbrojtjes së topografisë së qarqeve të integruara.

Pas debatit Komisioni nxori këtë

Përfundim

- I. Miratohet në parim Projektligji për përcaktimin e të drejtave dhe të mbrojtjes së topografisë së qarqeve të integruara

V. Të ndryshme:

Përfundim: Komisioni u pajtua që sezoni pranveror i punës së Komisionit për ETIETT- it të legjislaturës së tretë përfundoi punën sipas planprogramit.

Mbledhja përfundoi në orën 12:00

Kryetarja e Komisionit

Myzejene Selmani